

V E N D I M
Nr. 354, datë 28.7.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 520, DATË 21.8.1998 “PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË
KOMISIONIT TË PËRBASHKËT ITALO-SHQIPTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në procesverbalin e Komisionit të Përbashkët Italo-Shqiptar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 21.8.1998, të bëhen rialokimet dhe shtesat, sipas pasqyrës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e shumës shtesë, prej 20 (njëzet) miliardë lirash italiane, në formën e kredisë së butë, në procesverbalin e komisionit të përbashkët italo-shqiptar, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 21.8.1998, duke krijuar një paketë prej 42 (dyzet e dy) miliardë lirash italiane, për blerje mallrash e pajisjesh, në kuadrin e programit “Commodity Aid”.

3. Ngarkohen Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të programojnë përdorimin e paketës prej 42 (dyzet e dy) miliardë lirash italiane, në përputhje me nevojat emergjente të sektorëve parësorë. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e programit “Commodity Aid”, prej 42 (dyzet e dy) miliardë lirash italiane.

4. Komponenti B.7, në pasqyrën që i bashkëlidhet vendimit, prej 27 (njëzet e shtatë) miliardë lirash italiane të përdoret për zgjerimin e projekteve ekzistuese në sektorët e furnizimit me energji, ujë dhe, në rast nevojë, edhe për shërbime parësore në bashki.

5. Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë të identifikojë, së bashku me palën italiane, mundësinë për rialokime të tjera, të mundshme nga paketa e bashkëpunimit, me synimin për t’i përdorur në kohë e me efektivitete këto burime financiare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Artikullimi i programit

A) Ndërhyrje në formë dhurate:	miliardë lira
1. Periferia urbane e Tiranës – Organizimi i komuniteteve	1.5
2. Ristrukturimi i strukturave shkollore	6
3. Programi në sektorin e mjedisit	1
4. Community Works	4
5. Programi i privatizimeve	2
6. Rimëkëmbja e shërbimeve kryesore bashkiake (Tiranë-Vlorë)	7.1
7. Njësitë e mbështetjes teknike Qeverisë Shqiptare	5.4
8. Regjistrimi i popullsisë	2
9. Programi në sektorin shoqëror dhe të punës	2
10. Krijimi dhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	1
TOTAL	32

* Shtesa prej 2 miliardë lira (kundrejt 30 miliardë që ishte më parë) sigurohet nga rialokimi i sa ishte parashikuar për asistencë teknike për SME-të në procesverbalin e kooperacionit të viteve 1992-1996.

B) Ndërhyrje si kredi ndihme	miliardë lira
1. Sektori rrugor: Rruga Rogozhinë-Vlorë (aksi Lushnjë-Fier)	30

2. Rehabilitimi i rrjetit elektrik të Tiranës, Faza e III-të dhe Asistencë teknike në menaxhimin e KESHit për përmirësimin e Administrimit të saj financiar dhe të investimeve përkatëse	28
3. Linja krediti për ndërmarrje të vogla e të mesme (industri dhe bujqësi)	5
4. Sistemi spitalor i Tiranës	10
5. Periferia e Tiranës: Komponentë infrastrukturor	6
6. Sektori ujor i Tiranës dhe asistencë teknike për menaxhimin dhe përmirësimin e administrimit të saj financiar dhe të investimeve përkatëse	60
7. Shtesë për projektet ekzistuese	27
8. Commodity Aid	42
TOTAL	208

** Shtesa prej 28 miliardë lira (kundrejt 180 mld lira që ishte më parë) sigurohet nga rialokimi i 8 mld lira që ishin parashikuar për linja kredie për SME-të në procesverbalin e kooperacionit të viteve 1992 – 1996, si dhe një angazhim i ri për 20 mld lira për ndihmë në mallra në mallra (Commodity Aid).